

# DITARI MUJOR

## DHJETOR 2024

### INICIATIVA RAJONALE ANTIKORRUPSION (RAI) MBLEDH NË TIRANË GRUPIN DREJTUES, MINISTRJA PIRDENI PREZANTON RISITË E STRATEGJISË KUNDËR KORRUPSIONIT

Iniciativa Rajonale Antikorrupsion (RAI), zhvilloi në Tiranë takimin e 44-të Grupit Drejtues, ku Shqipëria është anëtare prej vitit 2007. Përfaqësues nga 9 vende të rajonit dhe më gjérë ndanë jo vetëm praktikat efektive, por dhe mesimet e nxjerra nga zbatimi i politikave antikorrupsion përgjatë gjithë rajonit. E pranishme në takim, ministri Pirdeni u shpreh se takimi në kryeqytetin shqiptar përputhet me "Javën e Integritetit", një nismë që vendos në qendër të vëmëndjes promovimin e integrititetit dhe luftën kundër korrupsionit. "Mbledhja e Grupit Drejtues së RAI-t në Tiranë thekson angazhimin tonë të përbashkët pér avancimin dhe forcimin e mekanizmave pér qeverisje transparente dhe të përgjegjshme," tha Pirdeni. Më tej ministri u ndal tek Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, dokumenti politik themelor që parashtron zotimet konkrete të të gjitha institucioneve përgjegjëse pér thellimin e mëtejshëm të luftës kundër korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes.



### MINISTRJA PIRDENI PREZANTON KURSIN E KIE MBI PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT PËR TË GJITHË PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS PUBLIKE



Në kuadër të "Javës së Integritetit", ministri Pirdeni, mori pjesë në takimin e bashkëorganizuar nga Këshilli i Evropës dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), ku u prezantua kursi i Këshillit të Evropës "Hyrje në Parandalimin e Korrupsionit" pér gjithë punonjësit e administratës publike në nivel qendror dhe vendor. Në fjalën e saj, ministri Pirdeni, theksoi rëndësinë e kursit si një instrument praktik dhe i dobishëm pér administratën, pér t'u njohur më në detaje me format e korrupsionit dhe mënyrat e parandalimit të tij. "Ky trajnim është një hap i madh përpara në përpjekjet tona pér të ndërtuar një administratë publike më të përgjegjshme dhe më të përkushtuar ndaj standardeve të larta etike. Jam e bindur se ky kurs, tashmë i aksesueshëm pér të gjithë administratët publike, është projektuar pér të adresuar risqet e integritetit dhe pér të ndihmuar në krijimin e një kulture të re pune bazuar mbi integritetin," tha ministri Pirdeni. Kursi online "Hyrje në Parandalimin e Korrupsionit" përfshin 13 module gjithëpërfshirëse që trajtojnë aspektet kryesore të luftës kundër korrupsionit.

### "FORCIMI I INTEGRITETIT PËRMES EDUKIMIT, KËRKIMIT DHE DIGITALIZIMIT", MINISTRJA PIRDENI: JANË VITAL!

Në kuadër të "Javës së Integritetit", ministri Pirdeni, mori pjesë në konferencën e organizuar nga ICC Albania, Instituti pér Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Rrjeti Ballkanik pér Gazetari Investigative (BIRN) në bashkëpunim me MAPA. Ministri Pirdeni theksoi në fjalën e saj se edukimi, kërkimi dhe digitalizimi janë tematika vitale dhe gjenden gjërësisht të pasqyruar në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030. "Digitalizimi është tashmë aleati ynë më i fortë në rritlej e standardeve të integritetit, duke sjellë përmirësimë të prekshme në administratën publike dhe luftën kundër korrupsionit. Ministri nën vizoi gjithashtu se IA po injektohet në administratën publike pér të rritur efikasitetin dhe pér të adresuar sfida të tillë si transparenca në prokurimet publike, duke reduktuar mundësinë e ndërryrjeve korruptive. Në lidhje me edukimin, ministri përmendi iniciativat e rëndësishme si rishikimi i Kurrikulës së Integritetit pér shkollat fillore si dhe zbatimi i Projektit Edukativ Antikorrupsion pér shkollat e mesme.





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRË SHTETI PËR  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE ANTIKORRUPSIONIN

## DITA NDËRKOMBËTARE E ANTIKORRUPSIONIT, PREZANTOHET PROJEKTI "KRONIKAT E INTEGRITETIT"

Në Ditën Ndërkombëtare të Antikorruptionit, ministria Pirdeni, mori pjesë në prezantimin e projektit ndërgjegjësues "Kronikat e Integritetit". Projekti u realizua me mbëshqetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Byronë e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore të Departamentit Amerikan të Shtetit, si dhe Meridian International Center. E pranishme në takim ishte edhe znj. Nancy VanHorn, e ngarkuara me punë e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Ministria Pirdeni vuri në dukje rëndësinë e ndërgjegjësimit për luftën kundër korruptionit, duke e cilësuar këtë aktivitet si një element të rëndësishëm të përfshirë në "Javën e Integritetit," e cila ka mbledhur bashkë organizata, institucione, shqëri civile dhe qytetarë, për të promovuar rëndësinë e integritetit në të gjitha nivelet. Ministria gjatë fjalës vuri në pah reformat e thella që janë ndërmarrë për transformimin e administratës publike, përfshirë modernizimin përmes inovacionit, promovimin e meritokracisë dhe iniciativat e trajnimit përritjen e kapaciteteve të stafit.



## "SHQIPËRIA 2030 NË BE-RRUGA E REFORMAVE", MINISTRJA PIRDENI: SHQIPËRIA S'KA KOHË PËR T'U NDALUR



Ministrja Pirdeni mori pjesë në takimin e nivelit të lartë "Shqipëria 2030 në BE, Rruga e Reformave" ku theksoi nevojën e një angazhimi të gjithanshëm për përspejtimin e rrugës së Shqipërisë drejt integrimit evropian brenda dekadës aktuale.

Në fjalën e saj, ministria Pirdeni nënizoi se ky takim në fundin e vitit është shprehje e kuptimit se Shqipëria e sotme nuk ka kohë për të humbur por nuk ka kohë as për t'u ndalur drejt ngritjes së një standardi më të lartë në drejtim të qeverisjes së mirë, të luftës së pakompromistë kundër korruptionit dhe sundimit të ligjit.

Ministrja vlerësoi se Shqipëria është kthyer në një lider rajonal në fushën e reformës së administratës publike të forcuar tashmë në drejtim të organizimit të politikave, të forcimit të sistemit të menaxhimit financiar, por dhe në drejtim të ofrimit të shërbimeve digitale me efektivitet. Përtej rrugëtimit të deritanishëm, ministria Pirdeni nënizoi se momenti i krijuar kërkon gjithpërfshirje drejt ngritjes së një standardi më të lartë në drejtim të qeverisjes së mirë, të luftës së pakompromistë kundër korruptionit dhe sundimit të ligjit.

## TAKIMI "KUNDËR KORRUPTIONIT NË SEKTORIN E PROKURIMIT PUBLIK", MINISTRJA PIRDENI: SYNOJMË INTEGRITET DHE TRANSPARENCE

Në kuadër të "Javës së Integritetit", Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorruptionin organizoi takimin "Kundër Korruptionit në Sektorin e Prokurimit Publik" në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe mbëshqetjen e pranisë së OSBE-së në Tiranë. Prokurimi Publik luan një rol kryç në menaxhimin e financave publike. Prandaj, sigurimi i integritetit në ciklin e Prokurimit Publik është thelbësor për parandalimin dhe zbutjen e risqeve të korruptionit. Ministria Pirdeni tha në fjalën e saj se ka nisur të kryhet një vlerësim i thelluar dhe i detajuar i riskut të korruptionit për identifikimin e proceseve dhe procedurave më të eksponentuara ndaj korruptionit, si dhe formave të shfaqjes së tij në sektorin e Prokurimit Publik.

Një nga masat është trajnimi dhe certifikimi i detyrueshëm i të gjithë punonjësve të angazhuar në procedurat e Prokurimit Publik. Këto trajnime do të zhvillohen nga SPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) në bashkëpunim me APP-në dhe do të synojnë ngritjen e kapaciteteve profesionale të ekspertëve. Sipas ministres Pirdeni të gjithë duhet të provojnë se kanë standardet më të larta të integritetit.



## "JAVA E INTEGRITETIT", PREZANTOHET PLATFORMA "TRANSPARENT ALBANIA", PIRDENI: KRYEFJALË E TRANSPARENCËS BUXHETORE

Në përmbyllje të 'Javës së Integritetit', Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, prezantoi detaje nga platforma 'Transparent Albania', një model inovativ për rritjen e transparencës. Kjo iniciativë e re e qeverisë Shqiptare ka për qëllim rritjen e transparencës në shpenzimet buxhetore duke i ofruar qytetarëve, organizatave dhe medias akses më lehtë dhe më të shpejtë në informacionet shtetërore.

Ministrja Pirdeni e vlerësoi platformën si një pikë kthuese për qeverisjen transparente në vendin tonë që promovon llogaridhjen duke garantuar qytetarëve qasje të qartë në informacion mbi veprimtarinë e qeverisë. Më tej ministrija Pirdeni tha se në "Transparent Albania", qytetarët do mësojnë në kohë reale në një gjuhë pa shumë burokraci dhe teknike se si dhe ku po shpenzohen paratë e tyre. "Platforma synon të jetë një mjet i vlefshëm në shërbim të çdo qytetari të angazhuar, që kërkon të dijë në moment dhe me saktësi, pa shumë burokraci dhe gjuhë teknike, se ku shkojnë paratë e tij, se si bëhen politikat në emër të tij dhe se si institucioni publik angazhohet për të tashmen dhe për të ardhmen e përbashkët. Me Transparent Albania, synojmë që të gjithë të kenë, në kuptimin më të parë të fjalës, shtetin të aksesueshëm në telefon," tha Pirdeni.

Platforma "Transparent Albania" është pjesë e angazhimit të qeverisë shqiptare për



## DREJTORI EKZEKUTIV I TI, DANIEL ERIKSSON: "TRANSPARENT ALBANIA" RRIT TRANSPARENÇËN, SHQIPËRIA SHEMBULL PËR VENDET ME SFIDA NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT



Në myllje të "Javës së Integritetit" MAPA prezantoi platformën digitale "Transparent Albania". Në forumin "Ndërtimi i Besimit: Rruja e Shqipërisë drejt BE-së për qeverisje transparente", u mbaj paneli me tematikë "Perspektivat Evropiane dhe Ndërkombëtare" nën moderimin e Drejtoreve së Kabinetit të Ministrave të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin znj. Fotjona Taçë, e cila hapi një dialog të thelluar mbi rëndësinë e transparencës dhe integritetit. Drejtori Ekzekutiv i TI, Daniel Eriksson e cilësoi platformën "Transparent Albania" si një nismë të rëndësishme dhe novatore, duke theksuar se ajo përfaqëson një hap të madh përparrë për Shqipërinë në përbushjen e standardeve më të larta të qeverisjes së hapur, integrititet, transparencës proaktive dhe garantimit të së drejtës për informim. Më tej Eriksson u shpreh se Shqipëria ka bërë progres dhe se ka potencial për të përmirësuar performancën e saj por dhe se është një shembull përvendet që hasin sfida në luftën kundër korruptionit.

## RAPORTI I MONITORIMIT SIGMA 2024: SHQIPËRIA, LIDER RAJONAL NË 4 NGA 6 FUSHAT E VLERËSIMIT

Raporti i Monitorimit SIGMA 2024, i cili vlerëson performancën e administratës publike në vendet e rajonit ka renditur sërisht Shqipërinë në krye të listës për securinë në katër nga gjashtë fushat e vlerësimit në administratën publike. "Shqipëria mbetet lider rajonal në funksionimin e administratës publike në 4 nga 6 fushat tematike, veçanërisht në menaxhimin e financave publike, menaxhimin e shërbimit civil dhe burimeve njerëzore, si dhe në zhvillimin dhe koordinimin e politikave për reformën në administratën publike," shkruhet në raportin "Parimet e Administratës Publike". Raporti evidenton krijimin e pozicionit të Ministrave të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin si zhvillim pozitiv. SIGMA vlerëson që rekrutimi në administratën publike shqiptare kryhet i bazuar në meritë dhe transparencë, dhe se rritja e pagave e ka bërë shërbimin civil më tërheqës. Në drejtim të garantimit të llogaridhënieve dhe mbikëqyrjeve në sektorin publik, SIGMA vë në dukje se transparenca ka shënuar përmirësim, duke përfshirë konsultimet publike dhe qasjen në informacion. Sa i takon fushës së vlerësimit për digitalizimin dhe ofrimin e shërbimeve publike sipas SIGMA-s, administrata publike ka avancuar ndjeshëm në këtë drejtim.

